



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 59

Tiranë – E premte, 17 prill 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 28/2015 datë 26.3.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator për fondet e granteve, për ndërtimin e kapaciteteve për koncesionet për investimet në energji dhe industri.....	2595
Ligj nr. 29/2015 datë 26.3.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.....	2603
Vendim i Kuvendit nr. 42/2015, datë 2.4.2015	Për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Mark Frroku.....	2608
Vendim i Kuvendit nr. 43/2015, datë 2.4.2015	Për zgjedhjen e zonjës Merita Bejtja Inspektore e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë.....	2608
Vendim i Kuvendit nr. 44/2015, datë 9.4.2015	Për mosmiratimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë””.....	2609
Vendim i Kuvendit nr. 45/2015, datë 9.4.2015	Për mosmiratimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.....	2609
Vendim i Kuvendit nr. 46/2015, datë 9.4.2015	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Markelian Koça anëtar i Gjykatës së Lartë.....	2609
Vendim i Kuvendit nr. 47/2015, datë 9.4.2015	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Fuat Vjerdha anëtar i Gjykatës së Lartë.....	2609
Rezolutë e Kuvendit datë 9.4.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së RTSH-së për vitin 2014.....	2610
Kërkesë e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 706/4, datë 8.4.2015	Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i rrugëve hyrëse dhe urave (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriatik”).....	2611
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Rahmi Como.....	2622
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Florenc Llukan Nito.....	2622



LIGJ
Nr. 28/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, DHE
BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI
ADMINISTRATOR PËR FONDET E
GRANTEVE, PËR NDËRTIMIN E
KAPACITETEVE PËR KONCESIONET
PËR INVESTIMET
NË ENERGJI DHE INDUSTRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator për fondet e granteve, për ndërtimin e kapaciteteve për koncesionet për investimet në energji dhe industri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.3.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9044, datë 10.4.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Marrëveshje Granti nr. C29314/NONC-2010-12-04

MARRËVESHJE GRANTI

Për Shqipërinë: Ndërtimi i Kapaciteteve për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri në Shqipëri, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si Administratore për Fondet e Granteve të dhëna nga Fondi i Ri i Bashkëpunimit me Norvegjinë

MARRËVESHJE GRANTI

Marrëveshja e Grantit nr. C29314/NONC-2010-12-04, datë ... ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Përfituesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka ose BERZH) me selinë e saj tek One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbretëria e Bashkuar, një institucion ndërkombëtar financiar i krijuar sipas Marrëveshjes Themeluese të Bankës, të nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, që vepron si administratore e fondeve të grantit që gjenden në Fondin e Ri të Bashkëpunimit me Norvegjinë, të dhënë nga Qeveria e Norvegjisë (Donatori).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Bankës i është kërkuar të shqyrtojë ofrimin e bashkëpunimit teknik për Përfituesin në formën e shërbimeve të konsulencës së financimit për ofrimin e Ndërtimit të Kapacitetit për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri në Shqipëri (“Projekti”, “Shqipëri: Ndërtimi i Kapaciteteve për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri”), ku asistenca teknike ofrohet për ndërtimin e kapaciteteve për të eliminuar barrierat dhe nxitur investimet në energjinë e rinovueshme në Shqipëri (Shërbimet),

duke marrë në konsideratë se Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Ministria e Energjisë dhe Industrisë) duhet të prokurorë një konsulent (Konsulent) në pajtim me politikat dhe rregullat e prokurimit dhe rregullat e tjera të BERZH-it,

duke marrë në konsideratë se Ministria e Energjisë dhe Industrisë lidh një Kontratë Konsulence për dhënien e shërbimeve me Konsulentin (Kontrata e



Konsulencës) në kufirin tavan prej 636,634.00 eurosh,

duke marrë në konsideratë senë pajtim me Marrëveshjen e Fondit të Bashkëpunimit Teknik ndërmjet Donatorit dhe Bankës, Donatori ka aprovuar dhe ka rënë dakord të ofrojë fonde deri në 636,634.00 euro, mbi bazë granti (Granti) për të financuar shërbimet e një Konsulenti me termat dhe kushtet e parashikuarmë poshtë,

duke marrë në konsideratë se Përfituesi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në pajtim me ligjin shqiptar për t'i ofruar Grantin Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nëpërmjet një marrëveshjeje transferimi për qëllimin e specifikuar në termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje,

duke marrë në konsideratë se Përfituesi do të garantojë si kusht për marrjen e Grantit që, duke njohur marrjen e përfitimeve të shërbimeve, Ministria e Energjisë dhe Industrisë do të respektojë të gjitha detyrimet kontraktuale të shprehura në këtë Marrëveshje Granti si të jenë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas termave dhe kushteve të përcaktuar,

kështu palët bien dakord për termat specifike të mëposhtëm:

Neni 1

Përkufizime

1.01 Përkufizimet dhe interpretimi

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm me germa kapitale kanë kuptimet e caktuara më poshtë:

a) “Kostoja e Porosive” është kostoja për shërbimet;

b) “Banka” ose “BERZH-i” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim;

c) “Ministria e Energjisë dhe Industrisë” është Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pala së cilës do t'i jepen shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës;

d) “Angazhimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë” është kontributi financiar që Ministria e Energjisë dhe Industrisë do të japë kundrejt kostonë së dhënies së shërbimeve;

e) “Konsulenti” është pala e cila do të kryejë shërbimet;

f) “Kontrata e Konsulencës” është marrëveshja që lidhet ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Konsulentit për kryerjen e shërbimeve;

g) “Vendi i Porosisë” është Shqipëria;

h) “Donatori” është dhënësi i fondeve të Grantit, siç specifikohet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje;

i) “Granti” është shuma e fondeve që i ofrohen Bankës nga Donatori, si administratore për qëllimin e financimit të Kontratës së Konsulencës;

j) “Marrëveshje Granti” është Marrëveshja dhe të gjitha shtojcat e bashkëlidhura, e cila mund të ndryshohet herë pas here;

k) “Shuma Maksimale e Kontratës” është shuma maksimale deri në 636,634.00 euro që duhet t'i paguhet Konsulentit sipas një kontrate konsulence, duke përfshirë të gjitha tarifat, dietat dhe shpenzimet;

l) “Drejtuesi i Operacionit” është anëtari i personelit të Bankës, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës;

m) “Përfituesi” është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave;

n) “Shërbimet” janë shërbimet që kryhen nga Konsulenti për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë sipas parashikimit në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referenca te një akt është referencë te ky akt dhe te rregulloret e bëra në pajtim me këtë akt dhe ky akt dhe rregulloret mund të ndryshohen ose modifikohen herë pas here dhe mbeten në fuqi dhe te çdo akt dhe rregullore që mund të miratohen dhe kanë fuqinë e plotësimi ose zëvendësimi të këtij akti dhe rregulloreve.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë te një gjini përfshin një referencë te të gjitha gjinitë e tjera, numri njëjës përfshin shumësin dhe anasjellas, ndërsa referencat te personat përfshijnë organizatat e regjistruara, të paregjistruara dhe partneritetet. Referenca te një person përfshin pasuesit dhe drejtëmarrësit e lejuar.



Neni 2 Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord t'i ofrojë Përfituesit, sipas termave dhe kushteve të parashikuar në këtë Marrëveshje, Grantin në një shumë që nuk kalon 636,634.00 euro ose ekuivalentin e saj.

b) Granti do të përdoret vetëm për të financuar shërbimet gjatë afatit të angazhimit të Konsulentit.

2.02 Disbursimi

a) Përfituesi dhe Banka bien dakord që Banka autorizohet të kryejë disbursime drejtpërdrejt te Konsulenti, në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

b) Shuma e Grantit do të livrohet nga Banka drejtpërdrejt te Konsulenti, në emër të dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në pajtim me dispozitat e Kontratës së Konsulencës.

c) Me marrjen e një fature dhe të dokumenteve mbështetëse nga Konsulenti, të paraqitura në pajtim me dispozitat e Kontratës së Konsulencës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pa vonesë, kontrollon dhe verifikon faturën dhe përmbushjen e arsyeshme të atyre shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse ato shërbime konstatohen të jenë të pranueshme dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë është e bindur se shumat e caktuara në faturë përputhen me shumat e parashikuara në Kontratën e Konsulencës, fatura, dokumentet mbështetëse dhe një pasqyrë (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), që certifikon aprovimin e shërbimeve, duhet t'i kalohet Bankës për pagesë në Zyrën e Rezidentit të Bankës në Tiranë, godina "Torre Drin", kati 4-t, rruga "Abdi Toptani," Tiranë, Shqipëri.

2.03 Taksat dhe detyrimet

a) Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të financuar tatimet jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) në lidhje me shërbimet e kësaj Marrëveshjeje Granti, të vendosura sipas ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi në vendin e porosisë.

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton Bankën nëse taksa jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) janë të kërkueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës.

c) Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord që çdo taksë jo e drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme, t'i paguhet Konsulentit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

d) Nëse është e kërkueshme një taksë jo e drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në), në kohën e dhënies së certifikatës Bankës sipas dispozitës 2.02(d), Ministria e Energjisë dhe Industrisë vërteton, gjithashtu, pagesën prej saj të taksave jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme për çdo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe merr përsipër të paguajë taksën jo të drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) për këtë faturë.

e) Mospagimi nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë e ndonjë takse jo të drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) mund të rezultojë në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me dispozitën 5.03.

Neni 3 Ekzekutimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë bashkëpunojnë plotësisht në lidhje me administrimin e Kontratës së Konsulencës.

Banka, Përfituesi dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, herë pas here dhe me kërkesë të një prej tyre, shkëmbejnë mendime në lidhje me përparimin e Projektit, shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet Granti, përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Konsulentit, sipas Kontratës së Konsulencës dhe i japin palës tjetër të gjithë informacionin përkatës që pala tjetër mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar në natyrën ose objektin e Projektit, shërbimeve ose punës apo operacioneve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose çdo ngjarje ose kushti tjetër që mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në përmbushjen e Projektit ose shërbimeve, ose kryerjen e aktivitetit apo operacioneve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.



c) Pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk kryen asnjë ndryshim të konsiderueshëm, duke përfshirë vendimin në lidhje me porositë dhe nënkontraktimin, në Kontratën e Konsulencës pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga Banka dhe ky pëlqim nuk refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Në çdo rast, të gjitha ndryshimet e Kontratës së Konsulencës i njoftohen Bankës nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3.02 Regjistrat dhe raportet

a) Ministria e Energjisë dhe Industrisë:

i) mban në fuqi procedura dhe regjistra të përshtatshëm për të regjistruar dhe monitoruar progresin e shërbimeve (duke përfshirë koston e tyre dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre) dhe për të identifikuar shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe do t'ua ofrojë këta regjistra përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës;

ii) mban llogari dhe pasqyra financiare (bilance, pasqyra të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra mbështetëse) të nevojshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e shërbimeve, duke përfshirë koston dhe përfitimet e përfutuara prej këtyre shërbimeve, dhe për t'i dhënë Bankës, me kërkesë, kopje të këtij informacioni dhe me detaje që Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme;

iii) u jep mundësi përfaqësuesve të Bankës, me kërkesë të Bankës, të vizitojnë çdo mjedis të përfshirë ose të përmendur në Projektin ose Kontratën e Konsulencës dhe të shqyrtojnë shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe çdo fabrikë, instalim, kantier, punë, ndërtesa, prona, pajisje, regjistra dhe dokumente që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose Konsulentit, sipas kësaj Marrëveshjeje ose Kontratës së Konsulencës;

iv) i jep përfaqësuesit të Bankës të gjithë informacionin që Banka kërkon, në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin dhe shërbimet, koston e tyre dhe, sipas rastit, përfitimet që nxirren prej tyre dhe shpenzimet e shumave të Grantit;

v) u ofron ose merr masa për t'u ofruar përfaqësuesve të Bankës menjëherë pas përgatitjes së tyre të të gjitha planeve, specifikimeve, raporteve, kontratave, dokumenteve

(duke përfshirë artikujt sipas Kontratës së Konsulencës) dhe çdo modifikim material të saj ose shtesë, me ato hollësi që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme;

b) Menjëherë pas përfundimit të shërbimeve, Ministria e Energjisë dhe Industrisë përgatit dhe i jep Bankës një raport në gjuhën e specifikuar, me atë objekt dhe hollësi që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe operimin e shërbimeve, koston dhe përfitimet e nxjerra ose që do të nxirren prej tyre dhe punën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Konsulentit dhe Bankës të detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së Grantit dhe Kontratës së Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjithë raportet dhe regjistrat e përgatitur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë përpilohen në formatin Microsoft Word dhe/ose Excel, të përputhshme me formatin Acrobat dhe jepen në format elektronik dhe në letër.

3.03 Konfidencialiteti

Përveçse me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi nuk deklarojnë apo bëjnë apo lejojnë që agjentët ose nënkontraktorët e tyre të deklarojnë kundrejt palëve të treta apo të përdorin për qëllimet e tyre ndonjë informacion në lidhje me shërbimet, Projektin ose Bankën, duke përfshirë informacionin në lidhje me Kontratën e Konsulencës. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi mund t'i japin këto të dhëna dhe informacione nëse kërkohet me ligj apo rregullore të zbatueshme, por vetëm atë pjesë të informacionit që në masën e lejuar nga ligji përkatës apo kërkesa rregullatore, të jetë e kërkuar ligjërisht për t'u dhënë. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi njoftojnë menjëherë Bankën.

3.04 Kryerja e operacioneve

Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Ministria e Energjisë dhe Industrisë e zhvillon aktivitetin dhe operacionet e veta (duke përfshirë operacionet e një filiali) në pajtim me standardet dhe praktikën e qëndrueshme administrative, teknike, financiare dhe mjedisore të njohura ndërkombëtarisht nën mbikëqyrjen e menaxhimit të kualifikuar dhe me përvojë të asistuar nga personeli kompetent në shifra të përshtatshme.

3.05 Mbështetja e Përfituesit



Përfituesi:

i) përmbush rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) mbështet Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë marrjen e të gjitha masave të nevojshme apo të dëshirueshme legjislative, rregullatore apo të tjera, dhe duke caktuar dhe ofruar apo duke marrë masa për të ofruar fonde dhe mbështetje për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në kohën e duhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për të përfunduar Projektin; dhe

iii) merr çdo masë, sipas ligjit shqiptar, të nevojshëm për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Përfaqësimi

4.01 Përfaqësuesi i Autorizuar

Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u ndërmarrë dhe çdo dokument i kërkuar apo i lejuar për t'u nënshkruar sipas kësaj Marrëveshjeje kryhet ose nënshkruhet:

a) në emër të Përfituesit, ministri i Financave;

b) në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë; dhe

c) në emër të Bankës nga drejtori, Bashkëpunimi Teknik ose një përfaqësues i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftimet ose kërkesat

Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim që kërkohet ose lejohet të kryhet në pajtim me këtë Marrëveshje bëhet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë konsiderohet të jetë dhënë ose bërë nëse dorëzohet personalisht te një përfaqësues i autorizuar i palës së cilës i drejtohet komunikimi ose kur i dërgohet me postë të regjistruar apo faks kësaj Pale në adresën e mëposhtme:

Për Përfituesin:	Në vëmendje të:	Z. Shkëlqim Cani Ministër i Financave
	Adresa:	Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, Shqipëri
	Tel.	+355 4 223 4647
	Faks:	+355 4 222 8494
Për Përfituesin e Grantit:	Në vëmendje të:	Z. Damian Gjinkuri Ministër i Energjisë dhe Industrisë Ministria e Energjisë

		dhe Industrisë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri
	Tel.	+355 4 222 2245
	Faks:	+355 4 223 4052
Për Bankën:	Në vëmendje të:	Raphael Rashid, "Drejtuesi i Operacioneve"
	Adresa:	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim One Exchange Square London EC2A 2JN, UK
	Tel.	+ 44 20 7338 6581
	E-mail:	rashidr@ebrd.com

a) Njoftimi konsiderohet të jetë kryer si më poshtë:

i) në rastin e dorëzimit dorazi ose me postë të regjistruar, në momentin e dorëzimit; dhe

ii) në rastin e faksit, pas transmetimit të konfirmuar.

B)Një palë mund ta ndryshojë adresën e saj për kryerjen e njoftimeve ose kërkesave,duke i bërë palës tjetër njoftim të arsyeshëm sipas kësaj dispozite.

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi

5.01Njoftimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton menjëherë Bankën për pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës ose për çdo ngjarje që mund të çojë në pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02Pezullimi i livrimeve

Nëse një prej ngjarjeve të mëposhtme ka ndodhur dhe vazhdon, Banka, duke njoftuar me shkrim Përfituesin pezullon pjesërisht ose plotësisht livrimet e kërkueshme pas kësaj nga Konsulenti, në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje:

a) Kontrata e Konsulencës është pezulluar ose përfunduar në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës;

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk u ka paguar Konsulentëve pjesën e tatimeve jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) për faturat e Konsulentëve në kohën e duhur në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës;



c) Ka ndodhur një kusht tjetër, i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyr ose rrezikon të ndërhyjë në kryerjen e suksesshme të shërbimeve ose Projektit, ose arritjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Banka, nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Përfituesit, mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, nëse:

i) një prej kushteve të përmendura në dispozitën 5.02 vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pasi Banka të ketë pezulluar plotësisht ose pjesërisht livrimet që kërkohen nga Konsulenti dhe për këtë i ka bërë njoftim me shkrim Përfituesit; ose

ii) Kontrata e Konsulencës ka skaduar ose ka përfunduar në pajtim me termat e saj; ose

iii) Përfituesi dhe Banka bien dakord ta përfundojnë në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) Donatori anulon financimin e Grantit; ose

v) prokurimi i një prej shërbimeve nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje; ose

vi) fondet e livruara sipas kësaj Marrëveshjeje, janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

b)Në çdo rast, Banka mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i bërë Përfituesit një njoftim jo më pak se dyzet ditë para.

5.04Procedura e prishjes

Pas prishjes së kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me dispozitën 5.03, Ministria e Energjisë dhe Industrisë merr masa të menjëhershme për të ulur humbjet dhe për t'i mbajtur shpenzimet e tjera sipas Kontratës së Konsulencës në një nivel minimal.

Neni 6

Të përgjithshme

6.01 Përjashtimi i përgjegjësisë

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Banka nuk i detyrohet Përfituesit, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose Konsulentit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kontratën e Konsulencës për asnjë humbje apo dëm, qoftë i shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi neglizhent i Bankës. Kjo dispozitë nuk zbatohet për asnjë veprim apo

mosveprim neglizhent të Bankës, i cili shkakton vdekjen, dëmtim personal të personelit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Konsulentit apo Ekspertëve.

6.02Zhdëmtimi

Ministria e Energjisë dhe Industrisë zhdëmton dhe, sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, mbron Bankën, drejtorët, nëpunësit, punonjësit, agjentët dhe kontraktorët e saj ndaj të gjitha pretendimeve, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, gjykimeve, humbjeve që rrjedhin nga ose në lidhje me një veprim apo mosveprim, qoftë me dashje, neglizhent apo tjetër, të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose konsulentit, punonjësve të tyre, nënkontraktorëve ose agjentëve apo me një shkelje prej tyre të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës ose mosrespektimit prej tyre të një akti, rregulli ose rregulloreje.

6.03 Praktika e ndaluar

Banka, pavarësisht ndonjë mjeti tjetër ndaj shkeljes së Marrëveshjes, mund ta prishë këtë Marrëveshje menjëherë nëse Përfituesi, dhe/ose Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në gjykimin e Bankës, është përfshirë në praktika të ndaluara në konkurrimin ose ekzekutimin e Kontratës së Konsulencës.

“Praktikë korruptive” është ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo, i një sendi me vlerë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë te veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e zgjedhjes ose ekzekutimin e Kontratës, me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

“Praktikë mashtrimi” është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpiket të çorientojë, me dashje ose nga pakujdesia, një palë për të përfutur një përfitim financiar ose tjetër ose të shmangë një detyrim.

“Praktikë detyruese” është cenimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të cenuar apo dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo, i një pale apo prone të palës për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e zgjedhjes ose ekzekutimin e Kontratës, me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo një avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje



ndërmjet dy ose më shumë palëve, e destinuar për të arritur një qëllim të padrejtë, duke përfshirë ndikimin e padrejtë të veprimeve të një pale tjetër që përfshin çdo marrëveshje ndërmjet konsulentëve (para ose pas paraqitjes së propozimeve), e destinuar për të caktuar çmimet në nivele jokonkurruese artificiale dhe për t'i hequr Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë avantazhet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

Ministria e Energjisë dhe Industrisë i lejon Bankës ose përfaqësuesve të saj të autorizuar të inspektojnë llogaritë dhe regjistrat e tyre në lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe shërbimeve, si dhe auditimin e këtyre llogarive nga auditët e caktuar nga Banka, nëse kjo kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimi

E pazbatueshme.

6.06 Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje interpretohet në pajtim me ligjin anglez. Çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo shkelje, përfundim apo pavlefshmëri të saj apo çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me pajtim, zgjidhet me arbitrazh në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit UNICITRAL, që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Do të ketë një (1) arbitër dhe autoriteti emëruar për qëllimet e rregullave UNICITRAL do të jetë LCIA (Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar). Selia dhe vendi i arbitrazhit është Londra, Angli, dhe gjuha angleze do të përdoret gjatë të gjithë gjykimit në arbitrazh. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas aktit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose tjetër, për të ankimuar ndonjë vendim arbitrazhi apo për të kërkuar paraprakisht interpretimin e një çështjeje ligjore nga gjykatat e Anglisë apo në institucione të tjera të ngjashme. Arbitri nuk autorizohet të japë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord të mos kërkojë nga asnjë autoritet gjyqësor, ndonjë masë të përkohshme apo kompensim para vendimit ndaj Bankës,

pavarësisht dispozitave të Rregullave të Arbitrazhit UNICITRAL.

c) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si heqje dorë apo modifikim nga Banka i një imuniteti, privilegji apo përjashtimi të Bankës, të dhënë në pajtim me Marrëveshjen Themeluese të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një konventë ndërkombëtare apo një ligj të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka i është nënshtruar shprehimisht arbitrazhit sipas seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje dhe për pasojë, dhe pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e saj (duke përfshirë, pa u kufizuar në paprekshmërinë e arkivave të saj), ajo njeh që nuk ka imunitet ndaj padisë dhe proceseve gjyqësore sipas nenit 5(2) të Instrumentit Statutor të vitit 1991, nr. 757 (urdhri i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim i vitit 1991) ose një dispozitë e ngjashme sipas ligjit anglez, në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi që është dhënë rregullisht ndaj saj si rezultat i nënshtrimit shprehimisht ndaj arbitrazhit sipas seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme për hyrjen e saj në fuqi, sipas ligjit shqiptar dhe, përveç kur pezullohet apo përfundohet në pajtim me nenin 5, mbetet në fuqi të plotë derisa të jenë përfunduar shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje, mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet Bankës dhe Përfituesit të nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje së bashku me shtojcat e saj, të ndryshuara herë pas here në pajtim me Dispozitën 6.08, përmban të gjithë mirëkuptimin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve dhe pezullon të gjitha propozimet ose marrëveshjet e tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë palë nuk është mbështetur në ndonjë angazhim apo përfaqësim të bërë nga pala tjetër që nuk është kusht i kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasuesit

Kjo Marrëveshje detyron dhe është në favor të pasuesve përkatës dhe drejtëmarrësve të lejuar të palëve në të.



6.11 Përjashtimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë sipas aktit të Kontratave (të drejtat e palëve të treta), të vitit 1999, të zbatueshme nga ndonjë person apo subjekt që nuk është palë në të, përveç personave apo subjekteve që janë pasues ose përfitues me cedim të të drejtave të një pale që konsiderohet të jetë palë në këtë Marrëveshje.

6.12 Mbetja në fuqi e dispozitave

Dispozitat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 mbeten në fuqi pas përfundimit ose kalimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja është gjuha e Marrëveshjes. Të gjitha komunikimet, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontrata e Konsulencës përgatiten dhe paraqiten në gjuhën angleze.

6.14 Garanci të tjera

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, vetë ose nëpërmjet Konsulentit, në çdo kohë dhe herë pas here, me kërkesë të Bankës, nënshkruan dhe paraqet çdo dokument tjetër apo kryen veprime të tjera që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, me qëllim që të provojë, të përmbushë ose t'i japë fuqi të plotë ligjore termave, kushteve, synimit dhe kuptimit të kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Koha me rëndësi të madhe

E pazbatueshme.

6.16 Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në tri kopje origjinale, ku të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të vetmen Marrëveshje.

6.17 Logoja e BERZH-it

Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi janë vënë në dijeni që logoja e Bankës është një markë shërbimi e regjistruar dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi, nuk e riprodhojnë logon pa lejen specifike me shkrim të Bankës.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në tri kopje në gjuhën angleze, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

Për dhe në emër të përfituesit

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave

.....

Shkëlqim Cani

Ministër

Ministria e Financave

Datë:

Për dhe në emër të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

.....

Steven Gillard

Këshilltar i Lartë

Bashkëpunimi Teknik

Datë:

SHTOJCA A FORMULARI I DEKLARIMIT TË APROVIMIT TË SHËRBIMEVE

SHTOJCË E MARRËVESHJES SË GRANTIT FORMULARI I DEKLARATËS SË APROVIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

Të nënshkruhet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe të dërgohet me faturën(at) për Shërbimet nga Konsulenti

Fatura nr. Data e faturës: Shuma e faturës:

Marrëveshje Granti nr. C29314/NONC-2010-12-04OL: Raphael Rashid

1. Në pajtim me Kontratën e konsulencës për ndërtimin e kapacitetit për koncesionet për investimet në energji dhe industri (shërbimet), datë _____, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe _____ (Konsulenti); dhe në pajtim me klauzolën 2.02(d) të Marrëveshjes së Grantit për Shërbimet, datë _____, të lidhur ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) dhe Përfituesit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë deklaron se:

i) Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka marrë dhe është e bindur për Shërbimet e Konsulentit që ishin kontraktuar në Kontratën e Konsulencës dhe që mbulohen nga faturat e bashkëlidhura;

ii) Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka verifikuar faturat dhe të gjitha dokumentet



shoqëruese, të cilat lidhen me kryerjen e shërbimeve kundrejt shumave të përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe është e bindur që:

a) fatura(t) është (janë) një përfaqësim i saktë i shërbimeve të dhëna nga Konsulenti; dhe

b) shuma(t) e caktuar(a) në faturë(at) përputhet(n) me shumën(at) e përcaktuar(a) në Kontratën e Konsulencës;

ii) fatura(t) dhe të gjitha dokumentet shoqëruese janë paraqitur së bashku me deklarin e aprovimit të ekipit të faturimit TC, Njësisë së Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesë; dhe

iv) Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka paguar Konsulentit të gjitha taksat jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë TVSH-në, në lidhje me faturat e mëparshme dhe merr përsipër të paguajë taksat jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë TVSH-në, në lidhje me faturën(at) bashkëlidhur brenda 30 ditëve nga data e këtij deklarimi aprovimi.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë deklaron që nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti, Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon Bankën të kryejë livrimin e rënë dakord në Kontratën e Konsulencës të Konsulenti në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Në dëshmi të kësaj, pala, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar, ka nënshkruar këtë deklaratë, më

PËR DHE NË EMËR TË

Ministër i Energjisë dhe Industrisë

LIGJ

Nr. 29/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.3.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9045, datë 10.4.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËRMBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane (më poshtë të quajtura “Palët”),

duke pranuar rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit të ndërsjellë;



duke pranuar se bashkëpunimi i mirë kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve;

duke pranuar nevojën për vendosjen e rregullave në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer brenda sferës së bashkëpunimit politik, ushtarak, ekonomik, ligjor, shkencor dhe teknologjik apo tjetër, si dhe informacionit të klasifikuar në procesin e këtij bashkëpunimi në përputhje me rregulloret kombëtare të Palëve, si dhe angazhimet e tyre ndërkombëtare dhe për Italinë, me ato që rrjedhin nga anëtarësimi në BE;

me synim garantimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar që është klasifikuar nga një Palë dhe i është transferuar Palës tjetër;

me dëshirën për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar që do të shtrihet për të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që do të lidhen ndërmjet Palëve dhe kontratat që do të jepen ndërmjet organizatave të Palëve, të cilat parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” është çdo informacion, regjistrim, aktivitet, material, duke përfshirë objektet dhe mjediset, të cilëve u është dhënë klasifikimi i sigurisë në pajtim me legjislacionet e brendshme.

2. “Palë pritëse” është Pala së cilës i transmetohet informacioni i klasifikuar.

3. “Pala e origjinës” është Pala që nis informacionin e klasifikuar.

4. “Palë e tretë” është çdo shtet, organizatë ndërkombëtare ose subjekt juridik që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

5. “Autoriteti kompetent i sigurisë” do të thotë autoriteti, i cili në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës përkatëse, përmbush politikën shtetërore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ushtron kontroll të përgjithshëm në këtë sferë, si dhe kryen zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto autoritete janë renditur në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Parimi i “Nevojës për njohje” është domosdoshmëria për të pasur akses në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre zyrtare konkrete.

7. “Leje sigurie personeli” është dokumenti i dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë, për një shtetas të një Pale për akses tek informacioni i klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të sigurisë.

8. “Kontratë e klasifikuar” është marrëveshja ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve shtetërore ose subjekteve juridike që krijon dhe përkufizon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre, të cilat përmbajnë dhe nënkuptojnë aksesin të një informacioni i klasifikuar dhe të cilave u është dhënë një nivel klasifikimi sigurie.

9. “Kontraktor” është një subjekt, fizik ose juridik, që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

10. “Leje sigurie strukture” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent i sigurisë, i cili konfirmon që subjekti juridik është i autorizuar të trajtojë dhe të menaxhojë informacion të klasifikuar të një nivel i caktuar klasifikimi, në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm për sigurinë.

11. “Vizitorë” janë përfaqësues zyrtarë të një Pale, që kërkojnë të vizitojnë objektet dhe mjediset e Palës tjetër, të përfshira në aktivitete që lidhen me informacionin e klasifikuar.

12. “Shkelje e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që rezulton ose mund të rezultojë në akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

Neni 2

Qëllimi dhe zbatueshmëria

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është garantimi i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe vendosja e procedurave dhe rregullave të përbashkëta, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet Palëve dhe ndërmjet subjekteve publike dhe private të Palëve, në lidhje me çështjet ndërkombëtare, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, sferën industriale dhe çdo sferë tjetër aktiviteteve.



Neni 3

Nivelet e klasifikimit të sigorisë

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigorisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigorisë të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm të Palës përkatëse:

Për Republikën e Shqipërisë	Për Republikën Italiane	Ekuivalenti në anglisht
TEPËR SEKRET	SEGRETISSIMO	TOP SECRET
SEKRET	SEGRETO	SECRET
KONFIDENCIAL	RISERVATISSIMO	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	RISERVATO	RESTRICTED

Neni 4

Autoritetet kompetente të sigorisë

1. Autoritetet kompetente të sigorisë së Palëve janë si më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë

Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

- Për Republikën Italiane

Departamenti i Informacionit për Sigurinë - Organi i Sigurisë Kombëtare

2. Autoritetet Kompetente të Sigurisë njoftojnë njëra-tjetrën për legjislacionin e brendshëm të sigorisë në fuqi, që rregullon mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i ngushtë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të sigorisë mund të zhvillojnë konsultime me kërkesën e bërë nga një prej tyre.

4. Çdo Palë njeh reciprokisht certifikatat e sigorisë së personelit dhe certifikatat e sigorisë industriale, të lëshuara në pajtim me legjislacionet e brendshme.

5. Me kërkesë, autoritetet kompetente të sigorisë, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, ndihmojnë njëri-tjetrin në shkëmbimin e të dhënave përkatëse, për procedurat e certifikatave të sigorisë së personelit dhe certifikatave të sigorisë industriale.

6. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standardet e krahasueshme të sigorisë, autoritetet përkatëse kompetente të sigorisë, me kërkesë, i japin njëri-tjetrit informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikën e sigorisë, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të zbatuara nga Pala përkatëse.

Neni 5

Parimet e sigorisë

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, Palët zbatojnë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që gjenerohet ose shkëmbehet zakonisht sipas kësaj Marrëveshjeje. I njëjti nivel mbrojtjeje sigurohet për këtë informacion të klasifikuar, siç parashikohet për informacionin e klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigorisë.

2. Aksesit në informacionin e klasifikuar kufizohet tek ata persona që kanë nevojë për njohje, pasi të kenë marrë lejen e sigorisë nga autoriteti kompetent i sigorisë dhe të jenë informuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, në përputhje me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigorisë të informacionit, i cili aksesohet.

3. Pala pritëse është e detyruar:

a) të mos i japë informacion të klasifikuar një Pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës së origjinës;

b) t'i vendosë informacionit të klasifikuar nivelin e klasifikimit të sigorisë, të barasvlershëm me atë të parashikuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe në vazhdimësi të garantojë mbrojtjen në pajtim me legjislacionet e brendshme;

c) të mos e përdorë informacionin e klasifikuar për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë.

4. Parimet e mbrojtjes reciproke të informacionit të klasifikuar, të rëna dakord ndërmjet Palëve, zbatohen në të gjitha marrëveshjet dhe masat e tjera për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve.

Neni 6

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar deri në dhe, duke përfshirë nivelin “SEKRET / SEGRETO / SECRET” transmetohet nëpërmjet kanaleve diplomatike ose me shërbime korrieri ushtarak apo tjetër, të miratuar nga autoritetet kompetente të sigorisë së Palëve. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar nga niveli “KONFIDENCIAL/RISERVATISSIMO/CONFIDENTIAL” e lart. Informacioni i



klasifikuar “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” dërgohet vetëm nëpërmjet kanaleve të certifikuara ushtarake ose diplomatike.

2. Nëse duhet të transmetohet një paketë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë bien bashkërisht dakord dhe miratojnë me shkrim mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për çdo rast të tillë.

3. Mjetet e tjera të miratuara të transmetimit ose të shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, duke përfshirë mjetet elektromagnetike, mund të përdoren nëse bihet dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

Neni 7

Shënjimi i informacionit të klasifikuar

1. Pala pritëse shënjon informacionin e klasifikuar me shënjimin përkatës të klasifikimit në pajtim me nenin 3.

2. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë shënjohen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë, si dhe origjinalet.

Neni 8

Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i shënuar me një nivel të klasifikimit të sigurisë “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” lejohet për përkthim dhe kopjim vetëm me lejen me shkrim të autoritetit përkatës kompetent të sigurisë të Palës së origjinës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të informacionit të klasifikuar shënjohen me shënjimin e klasifikimit origjinal. Ky informacion i riprodhuar vendoset nën të njëjtin kontroll, si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar bëhen nga individë me leje sigurie. Përkthimi shënjohet me shënjimin e klasifikimit origjinal dhe mban një shënim të përshtatshëm në gjuhën në të cilën është përkthyer që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të Palës së origjinës.

Neni 9

Asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet, në pajtim me legjislacionet e brendshme, për të mënjeluar rindërtimin e tij të plotë ose të pjesshëm.

2. Informacioni i klasifikuar “TEPËR SEKRET/SEGRETISSIMO/TOP SECRET” nuk asgjësohet. Ai i kthehet Palës përkatëse të origjinës.

3. Pala e origjinës, me anë të shënjitimit shtesë ose dërgimit të njoftimit pasues me shkrim, mund të ndalojë shprehimisht riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e informacionit të klasifikuar. Nëse ndalohet asgjësimi i informacionit të klasifikuar, ai i kthehet Palës së origjinës.

4. Në rastin e një situatë krize, informacioni i klasifikuar, i cili është i pamundur të mbrohet ose t'i kthehet Palës së origjinës, asgjësohet menjëherë në pajtim me legjislacionet e brendshme. Pala Pritëse njofton Palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 10

Kontratat e klasifikuara

1. Kontratat e klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me legjislacionin e brendshëm të secilës Palë. Me kërkesë, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës Palë, jep konfirmim me shkrim që një kontraktor i propozuar është pajisur me një certifikatë të përshtatshme kombëtare të sigurisë industriale, sipas nivelit të kërkuar për klasifikimin e sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk ka certifikatën e përshtatshme të sigurisë industriale, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës Palë mund të kërkojë që ai kontraktor të marrë leje sigurie.

2. Një klauzolë sigurie do të jetë pjesë përbërëse e çdo kontrate të klasifikuar ose nënkontrate, nëpërmjet të cilës kontraktori i Palës së origjinës specifikon se cili informacion i klasifikuar do t'i jepet ose gjenerohet nga Pala pritëse dhe cili nivel përkatës i klasifikimit të sigurisë i është caktuar këtij informacioni.

3. Detyrimet e kontraktorit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas një kontrate të klasifikuar u referohen, të paktën, sa më poshtë:

a) deklarimi i informacionit të klasifikuar ekskluzivisht personave që janë pajisur paraprakisht me lejen e përshtatshme të sigurisë së



personelit, të cilët kanë nevojë për njohje dhe që janë punësuar ose përfshirë në përmbushjen e kontratës;

b) transferimi i informacionit të klasifikuar me mjete sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

c) procedurat dhe mekanizmat e komunikimit të ndryshimeve që mund të lindin në lidhje me informacionin e klasifikuar, për shkak të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë ose në rastin e deklasifikimit;

d) një detyrim për të njoftuar, në kohën e duhur, autoritetin kompetent të sigurisë së kontraktorit për një akses faktik, në tentativë, të dyshuar ose të paautorizuar në informacionin e klasifikuar të kontratës;

e) përdorimi i informacionit të klasifikuar sipas kontratës vetëm për qëllimet në lidhje me objektin e kontratës;

f) respektimi rigoroz i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me procedurat për trajtimin e informacionit të klasifikuar;

g) dhënia e informacionit sipas një kontrate të klasifikuar një Pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhdëmtimin për humbje të mundshme të shkaktuara kontraktorëve nga akses i paautorizuar në informacionin e klasifikuar, specifikohet në më shumë hollësi në kontratën e klasifikuar përkatëse.

5. Kontrata e klasifikuar me nivel klasifikimi sigurie “I KUFIZUAR / RISERVATO / RESTRICTED” përmban një klauzolë të përshtatshme të sigurisë që identifikon masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Certifikata e sigurisë industriale për këto kontrata nuk kërkohet por është e nevojshme që subjekti privat të caktojë një individ përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “I KUFIZUAR / RISERVATO / RESTRICTED”, në pajtim me legjislacionet e tyre përkatëse të brendshme.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për nënkontratat.

Neni 11 Vizitat

1. Vizitat e kryera nga individët e një Pale të mjediset e Palës tjetër, të cilëve u duhet akses i në

informacionin e klasifikuar i nënshtrohen autorizimit paraprak me shkrim nga autoriteti kompetent i sigurisë së Palës ku zhvillohet vizita.

2. Kërkesa për vizitë paraqitet të paktën 20 ditë para datës së planifikuar. Në rastin e vizitave urgjente të paplanifikuara më parë, kërkesa për vizitë paraqitet të paktën pesë ditë para zhvillimit të vizitës.

3. Kërkesa për vizitë përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës;

b) kombësinë/shtetësinë e vizitorit;

c) pozicionin e vizitorit dhe emrin e organizatës që përfaqëson;

d) certifikatën e sigurisë së personelit të vizitorit me nivelin e përshtatshëm të klasifikimit, sipas rastit;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrin e organizatave dhe strukturave që kërkohen të vizitohen;

g) treguesin e pikës së kontaktit të subjekti publik apo privat që do të vizitohet, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, adresën e e-mail-it dhe numrin e telefonit.

5. Për vizitat e personelit të subjektit publik ose privat të një prej Palëve, deri te niveli “I KUFIZUAR/RISERVATO/RESTRICTED” bihet dakord drejtpërdrejt me subjektin publik ose privat të Palës tjetër. Subjekti publik ose privat pritës njofton autoritetin e vet kompetent për sigurinë në lidhje me vizitën.

6. Në rastin e projekteve ose kontratave që kërkojnë vizita periodike të klasifikuara si “KONFIDENCIAL/RISERVATISSIMO/CONFIDENTIAL” dhe më lart, autoritetet kompetente të sigurisë së Palëve njoftojnë me shkrim njëri-tjetrin duke dërguar një listë të personelit të autorizuar. Kjo listë nuk mund të jetë e vlefshme më shumë se 12 muaj.

7. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas legjislacionit përkatës të brendshëm.

Neni 12 Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e shkeljes së sigurisë, autoriteti kompetent i sigurisë, në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja e sigurisë, njofton me shkrim



autoritetin kompetent të sigurisë të Palës tjetër, në kohën e duhur dhe siguron hetim të përshtatshëm në pajtim me legjislacionet e brendshme. Pala tjetër, sipas rastit, bashkëpunon në hetim dhe informohet për rezultatet.

2. Në rast se shkelja e sigurisë ndodh në një Palë të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i Palës së origjinës ndërmerr të gjitha veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipas rastit.

Neni 13 Shpenzimet

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk përfshin asnjë shpenzim.

Neni 14 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet Palëve dhe nuk i paraqitet asnjë gjykatë ndërkombëtare apo një Palë të tretë.

2. Ndërkohë, Palët vazhdojnë të përmbushin dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 15 Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të denoncojë këtë Marrëveshje duke i bërë Palës tjetër njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje prishet gjashtë (6) muaj nga data në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e prishjes së kësaj Marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar, i transferuar në pajtim me këtë Marrëveshje, vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të.

Bërë në Tiranë, më 9.12.2014, në dy kopje origjinale, secila në shqip, italisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM Nr. 42/2015

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR ARRESTIMIN OSE HEQJEN E LIRISË TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ZOTIT MARK FRROKU

Në mbështetje të nenit 73, pikat 2 dhe 4, të Kushtetutës, nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Mark Frroku, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm me kërkesën nr. 1004/29 prot., datë 28.3.2015.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 2.4.2015

VENDIM Nr. 43/2015

PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS MERITA BEJTJA INSPEKTOR E PËRGJITHSHME E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 54 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Merita Bejtja zgjidhet Inspektore e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 2.4.2015

VENDIM
Nr. 44/2015

**PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHITUAR NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.4.2015

VENDIM
Nr. 45/2015

**PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.4.2015

VENDIM
Nr. 46/2015

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR
EMËRIMIN E ZOTIT MARKELIAN
KOÇA ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8897, datë 16 janar 2015,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Markelian Koça anëtar i Gjykatës së Lartë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.4.2015

VENDIM
Nr. 47/2015

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR
EMËRIMIN E ZOTIT FUAT VJERDHA
ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8898, datë 16 janar 2015,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit
Fuat Vjerdhaanëtar i Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 9.4.2015

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË RTSH-së PËR VITIN 2014**

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

1. Veprimtaria e RTSH-së, gjatë vitit 2014, është ushtruar në kushtet e mungesës së organeve drejtuese më të larta, si Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, Bordi i Administrimit, për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në Këshillin e ri Drejtues.

Rrjedhimisht, veprimtaria e RTSH-së, gjatë vitit 2014, është drejtuar konform ligjit nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

Ndërkohë, nga KDRTSH-ja e mëparshme nuk janë miraturar disa vendime që burojnë nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, pasi ai edhe gjatë vitit 2014 ishte pa mandat të anëtarëve të tij.

2. Kuvendi i Shqipërisë, i ndërgjegjshëm për bllokimin e tejzgatur dhe të pajustificuar të procesit zgjedhës të anëtarëve të KDRTSH-së nga ana e tij, shpreh përgjegjshmërinë për të zgjidhur në mënyrë urgjente ngërçin e drejtimit dhe përfaqësimit institucional në RTSH.

3. Procesi i ndërtimit të rrjeteve numerike të RTSH-së është i vonuar dhe afatet e përcaktuara në aktet nënligjore janë shkelur.

Nga të dhënat e raportimit për veprimtarinë e RTSH-së gjatë vitit 2014, Kuvendi konstaton se:

1. Një sërë detyrimesh ligjore nuk janë zbatuar dhe kanë ngecur, për sa kohë janë të varura nga vendimmarrjet e KDRTSH-së, ende i paformuar tërësisht në përbërjen e tij.

2. Ashtu si dhe vitin e kaluar, raporti është konceptuar si një raport tekniko-financiar, ku janë paraqitur shumë të dhëna lidhur me nivelin e të ardhurave të përfituara, shpenzimet përka-

tëse, si dhe disa tregues të ofrimit të shërbimeve dhe cilësisë së tyre.

3. Në raport mungojnë të dhëna mbi ecurinë e procesit të digjitalizimit, si dhe të koordinimit për këtë proces me institucione të tjera, si Ministria për Inovacionin dhe AMA.

4. Në raport mungon informacioni për kontrollin e kryer nga KLSH-ja, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ajo.

Kuvendi vlerëson se:

1. RTSH-ja për vitin 2014 ka rritur të ardhurat me 65 për qind, falë shtimit të arkëtimeve nga pagesat për aparatin marrës TV, si pasojë e bashkëpunimit shumë të mirë me OSHEE sh. a.

2. Gjatë këtij viti, RTSH-ja ka rritur cilësinë e programeve të transmetuara si operator publik, me ofrimin e shërbimeve të shumëllojshme audio dhe audiovizive.

3. Transmetimet e paketës digjitale në 5 kanale, nga të cilat 4 në formatin SD dhe 1 në formatin HD, kanë njohur rritje të audiencës.

Për sa më sipër, për vitin 2015, Kuvendi kërkon nga Këshilli i ri Drejtues, pas konstituimit të plotë të tij, të fokusohet në:

1. Emërimin sa më parë të drejtuesve të rinj të RTSH-së, të Bordit të Administrimit dhe të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit.

2. Miratimin e Statutit të RTSH-së.

3. Angazhimin maksimal të të gjitha strukturave të RTSH-së në procesin e digjitalizimit, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj.

4. Mbylljen e suksesshme të kalimit në transmetimet numerike, brenda afateve të përcaktuara, pas nënshkrimit të kontratës nga ana e Qeverisë, që mundëson kalimin në transmetime digjitale të RTSH-së.

5. Organizmin e një fushate të gjerë për informimin e publikut për procesin e digjitalizimit.

6. Përdorimin me efikasitet të plotë të 2 rrjeteve kombëtare, që mundësohet nga teknologjia digjitale: në rrjetin e parë, RTSH-ja do të transmetojë programet e saj dhe në rrjetin e dytë, programet e të gjithë operatorëve privatë televizivë, lokalë dhe rajonalë.



7. Reformimin shumëdimensional të RTSH-së, përmes një platforme gjithëpërfshirëse, që të forcojë statusin publik të saj.

KRYETARI
I Ilir Meta

Miratuar në datën 9.4.2015

KËRKESË
Nr. 706/4, datë 8.4.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe industrisë shpall kërkesën për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i Rrugëve Hyrëse dhe Urave (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriastik”).

Subjekti kërkuar i kësaj kërkesë është Trans Adriatik Pipeline AG Shqipëri, shoqëri e cila do të zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën

e vlerësimit të llogaritur në zbatim të ligjit të posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me Planin e Rehabilitimit të Jetesës, për personat sipas listave emërore bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehën nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse për shënimet e bëra nga ZVRPP-të në listën bashkëlidhur, mbi saktësimin dhe konfirmimin e sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjikhuri



LISTA E PËRDORUESVE TË PASURIVE ME PRONAR "SHTET" TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËS

Nr.	Pronari	ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip.m ² Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave
1	Shtet	3790	104/4	Pemëtore	181,50		2.184,00
2	Shtet	3790	253	Arë	99,44	5,97	1.260,00
3	Shtet	3790	104/8	Pemëtore	146,68	8,47	1.860,00
4	Shtet	3790	104/17	Pemëtore	15,13		180,00
5	Shtet	3790	104/11	Pemëtore	55,40		38.820,00
6	Shtet	3790	215/3	Pemëtore	84,53	21,59	1.284,00
7	Shtet	3790	237/1	Pemëtore	124,29		35.441,00
8	Shtet	3790	237/2	Pemëtore	48,83		21.538,00
9	Shtet	3790	225/4	Arë	93,21	24,67	1.416,00
10	Shtet	3790	257/1	Arë	73,10	137,59	2.532,00
11	Shtet	3790	256/1	Arë	42,35		504,00
12	Shtet	3790	252/2	Arë	26,02	0,39	312,00
13	Shtet	3790	247/4	Arë	34,38		19.020,50
14	Shtet	3790	255	Arë	3,95	0,06	96,00
15	Shtet	3790	221/2	Arë	340,88	74,57	4.992,00
16	Shtet	3790	111/2	Arë	282,01	313,88	139.802,00
17	Shtet	3790	257/2	Arë	48,91	16,5	27.647,00
18	Shtet	3790	104/1	Pemëtore	92,40		69.066,00
19	Shtet	3790	215/1	Pemëtore	257,71	233,67	63.144,00
20	Shtet	3790	237/3	Pemëtore	161,99		106.484,00
21	Shtet	3790	232/3	Pemëtore	354,61	357,08	502.902,60
22	Shtet	3790	256/2	Arë	66,78		76.904,00
23	Shtet	3790	227/2	Shkëmbore	179,50	191,05	87.457,00
24	Shtet	3437	141/5	Arë	176,78		2.124,00
25	Shtet	3437	146/4	Truall	17,98	0,75	228,00
26	Shtet	3437	197/1/1	Arë	145,16		1.740,00
27	Shtet	3787	375/40	Arë	124,05		63.688,00
28	Shtet	1342	107/8	Pemëtore	169		123.810,50
29	Shtet	3017	60/3	Pyll	16,00		7.967,00
30	Shtet	3017	60/2	Pyll	111,30		26.448,50
31	Shtet	3017	74/28	Truall	82,65	86,85	62.296,67
32	Shtet	3946	101/26	Arë	8,28	72,66	26.676,81
33	Shtet	3946	35/53	Arë		22,42	26.816,20
34	Shtet	3946	101/25	Arë	138,97	1,08	106.015,34
35	Shtet	3037	326/3	Arë	100,10	0,02	1.200,00
36	Shtet	3037	305	Arë	40,41		12.653,80
37	Shtet	3037	446	Arë	56,27	10,83	804,00
38	Shtet	3037	267/2	Arë	123,50	19,28	27.624,00
39	Shtet	3037	375	Arë	47,40		1.583,90
40	Shtet	3037	322/10	Arë	290,10	97,05	4.644,00
41	Shtet	3037	379/1	Arë	305,08	66,12	8.928,00
42	Shtet	3037	363	Arë	89,19	4,92	1.128,00
43	Shtet	3037	341/4	Arë	90,33		1.080,00
44	Shtet	3037	362/2	Arë	338,53	382,03	8.652,00
45	Shtet	3037	362/4	Arë	258,89		3.108,00
46	Shtet	3037	362/7	Arë	122,44	1,75	1.488,00
47	Shtet	3037	374/1	Arë	39,86	93,16	5.136,00
48	Shtet	3037	322/7	Arë	198,66	94,53	3.528,00
49	Shtet	3037	193/116	Pemëtore	23,66		288,00
50	Shtet	3037	193/61	Pemëtore	84,47		1.008,00
51	Shtet	3037	463	Arë	85,69		16.382,40
52	Shtet	3037	459	Pyll	213,87	237,51	5.424,00
53	Shtet	3037	460	Pyll	218,54	242,65	9.662,80
54	Shtet	3037	7/17	Arë	191,73	11,00	2.436,00
55	Shtet	3037	193/27	Arë	222,12	255,31	17.520,90
56	Shtet	3037	203/3	Truall		11,95	15.350,40
57	Shtet	3037	441	Arë	87,06	64,73	30.018,00
58	Shtet	3037	306/1	Arë	257,13	259,57	6.204,00
59	Shtet	3037	264/17	Arë	115,47		85.015,00
60	Shtet	3037	161/48	Arë	261,90	308,34	12.840,00
61	Shtet	3037	161/12	Arë	272,16	925,94	26.256,00
62	Shtet	3037	195/3	Arë	163,86	257,02	5.052,00
63	Shtet	3037	195/1	Arë	259,34	391,32	7.800,00
64	Shtet	3037	195/2	Arë	319,51	525,17	38.616,50
65	Shtet	3037	317/1	Arë	118,77	460,15	17.080,50



Nr.	Pronari	ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip.m ² Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave
66	Shtet	3037	354	Arë	192,24	251,28	39.870,00
67	Shtet	3037	264/1	Arë	15,39	65,21	43.365,00
68	Shtet	3037	7/34	Arë	647,28	308,20	11.460,00
69	Shtet	3076	36/2	Arë	1.114,33	218,46	15.984,00
70	Shtet	3076	30/3	Arë	317,46	0,08	3.804,00
71	Shtet	1949	55/2	Arë	209,51	180,96	9.360,00
72	Shtet	3596	217/147	Arë	30,91	3,19	204,00
73	Shtet	3596	414	Truall	59,63	56,43	1.392,00
74	Shtet	3596	217/145	Pemëtorë	138,30	21,43	9.431,00
75	Shtet	3596	217/141	Truall	8,97	21,75	372,00
76	Shtet	3596	217/135	Truall	0,26	11,05	132,00
77	Shtet	3596	217/133	Pemëtorë	4,99	1,26	31.172,00
78	Shtet	3596	309	Pemëtorë	280,26	29,24	3.708,00
79	Shtet	3596	271	Arë	513,98	16,40	3.180,00
80	Shtet	3596	218/13	Arë	147,28		39.425,00
81	Shtet	3596	217/114	Truall	518,29	18,63	6.444,00
82	Shtet	3596	416	Arë	166,11	145,88	65.323,42
83	Shtet	3596	217/139	Arë	186,57	215,15	2.412,00
84	Shtet	3596	217/134	Pemëtorë		95,94	38.252,00
85	Shtet	3596	217/143	Pemëtorë	27,07	45,47	864,00
TOTALI					13.378,46	7.995,61	2.357.323,74

*Përdoruesi likuidohet vetëm për vlerën e plotë të kulturave.

RRETHI SKRAPAR

KOMUNA QENDËR

FSHATI ZOGAS

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas.	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Çmimi Lekë/m ²	Vlera Lekë	Sip.m ² Shpronësim	Çmimi Lekë/m ²	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë
1	Myrteza	Jaçe	Hysa	3946	6/1	Arë	218,47	52,5	11.469,68	-	210		134.460,80	22.579,00	168.509,48
TOTALI							218,47		11.469,68	-		-	134.460,80	22.579,00	168.509,48

LISTA E PRONARËVE DHE PËRDORUESVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE ME MINIMUMIN E KOMPENSIMIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas.	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë
1	Fadil	Haki	Hysa	3946	83/32	Arë	211,09	22,60			56.000,00
2	Xheva	Haki	Hysa	3946	83/33	Arë	289,96	122,38	4.968,00		56.000,00
3	Tahir	Nesim	Hysa	3946	83/31	Arë	25,13		-		56.000,00
4	Bashkim	Mesim	Hysa	3946	83/30	Arë	6,84	-	-		56.000,00
5	Fatmir	Kasem	Hysa	3946	76/15	Arë	2,72	-	36,00		56.000,00
6	Myrteza	Jaçe	Hysa	3946	76/16	Arë	57,66	-	684,00		56.000,00
7	Rrahman	Jaçe	Hysa	3946	76/11	Arë	7,61	-	84,00		56.000,00
8	Kastriot	Sabri	Hysa	3946	6/2	Arë	143,85	72,58		18.063,00	56.000,00
9	Abaz	Jahja	Ismaili	3946	101/5	Pemëtorë + Truall	278,19	21,02			56.000,00
10	Behar	Baki	Ismaili	3946	35/19	Pemëtorë + Truall	-	9,56			56.000,00
11	Myrteza	Jaçe	Hysa	3946	35/15	Truall	-	4,37		39.866,00	56.000,00
12	Zenel	Avdurrman	Ismaili	3946	35/16	Truall	-	2,09		6.774,00	56.000,00
13	Ilmi	Xhafer	Hysa	3946	33/17	Arë	134,78	1,77	22.657,58		56.000,00
14	Tahir	Nesim	Hysa	3946	29/2	Arë+Truall	-	5,22	60,00	11.290,00	56.000,00
15	Tomorri	Muhammed	Balliu	3946	29/1	Arë		77,5	28.494,00		56.000,00
	Leonard	Kujtim	Hysaj						936,00		936,00
TOTALI							1.157,83	261,59	57.919,58	75.993,00	840.936,00

*Minimumi i Kompensimit në vlerën 56,000 lekë i takon pronarit, ndërsa përdoruesi likuidohet për vlerën e plotë të kulturave.



RRETHI KORÇË

KOMUNA VITHKUQ

FSHATI VITHKUQ

LISTA E PRONARËVE DHE PËRDORUESVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip.m ² Marrje në përdorim të përkohshëm	Cmimi/m ²	Vlera Lekë	Sip.m ² Shpronësim	Cmimi/m ²	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë
1	Gjergji	Rako	Shore	3790	240/2	Arë	13,58	82,5	1.120,35		330		42856	20.321,00	64.297,35
2	Gjergji	Rako	Shore	3790	231/1	Arë	203,52	82,5	16.790,40	265,56	330	87.634,80	91.889,21	101.606,00	297.920,41
3	Petra	Gaqi	Duni	3790	111/1	Arë	154,82	82,5	12.772,65	121,02	330	39.936,60	3.312,00		56.021,25
4	Dhimitraq	Koli	Tandimi	3790	232/1	Arë	153,47	82,5	12.661,28	220,17	330	72.656,10	145.500,00		230.817,38
5	Koçi	Llaqi	Radoveni	3790	247/3	Arë	34,10	82,5	2.813,25		330		80.967,50		83.780,75
6	Petra	Rako	Shore	3790	252/1	Arë	109,08	82,5	8.999,10	143,10	330	47.223,00	25.848,00		82.070,10
7	Perikli	Nini	Meko	3790	232/2	Arë	170,22	82,5	14.043,15	168,12	330	55.479,60	8.456,00		77.978,75
8	Spiro	Pandi	Dhëmbi	3790	225/7	Arë	377,93	82,5	31.179,23	454,30	330	149.919,00			181.098,23
TOTALI							1.216,72		100.379,40	1.372,27		452.849,10	398.828,71	121.927,00	1.073.984,21

LISTA E PRONARËVE DHE PËRDORUESVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE ME MINIMUMIN E KOMPENSIMIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip.m ² Marrje në përdorim të përkohshëm	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave	Vlera Totale Lekë
1	Gjergji	Thanas	Topi	3790	239/1	Arë	7,96		30.013,50	56.000,00
2	Mihal	Gjike	Naci	3790	114	Arë	223,69	33,82	1.393,20	56.000,00
3	Stavri	Kristaq	Tona	3790	251	Arë	144,40		2.179,50	56.000,00
4	Vasil	Kristo	Anxhara	3790	240/1	Arë	26,49		31.100,00	56.000,00
5	Vasil	Guri	Rapo	3790	104/3	Arë	2,64		31,68	56.000,00
6	Vasil	Ilo	Stran	3790	104/2	Pemëtores	15,65		192,00	56.000,00
7	Perikli	Nini	Meko	3790	104/5	Pemëtores	4,38		52,80	56.000,00
8	Dhimitraq	Nai	Pellumbi	3790	104/6	Pemëtores	26,19		52.586,48	56.000,00
9	Robert	Vani	Shore	3790	104/7	Pemëtores	8,07		96,00	56.000,00
10	Dhamo	Miti	Topi	3790	104/9	Pemëtores	8,18		13.984,00	56.000,00
11	Stavri	Gjike	Naci	3790	104/10	Pemëtores	75,26		19.980,00	56.000,00
12	Dhori	Dhamo	Topi	3790	104/16	Pemëtores	31,04		372,00	56.000,00
13	Gjergji	Safi	Shore	3790	215/2	Arë	54,66	32,11	1.044,00	56.000,00
14	Vasil	Thimi	Riska	3790	225/3	Arë	18,73		228,00	56.000,00
15	Dhimitraq	Koli	Tandimi	3790	225/5	Arë	68,92	37,21	17.750,00	56.000,00
16	Paskal		Duni	3790					1.910,12	1.910,12
17	Sandri	Llambi	Qirgazi	3790	225/6	Arë	47,82	24,19	6.600,00	56.000,00
18	Dhori	Dhamo	Topi	3790	232/4	Arë	155,26	5,10	8.920,00	56.000,00
19	Dhori	Dhamo	Topi	3790	235/1	Arë	173,57	51,89	13.212,00	56.000,00
TOTALI							1.092,91	184,32	201.645,28	1.009.910,12

*Minimumi i Kompensimit në vlerën 56,000 lekë i takon pronarit, ndërsa përdoruesi likuidohet për vlerën e plotë të kulturave.

RRETHI DEVOLL

BASHKIA BILISHT

FSHATI VISHOCË

LISTA E PRONARËVE DHE PËRDORUESVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Cmimi/m ²	Vlera Lekë	Sip.m ² Shpronësim	Cmimi/m ²	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë
1	Ethem	Zija	Hysolli	3787	838/27	Arë	244,67	161,5	39.514,21	47,61	646	30.756,06			70.270,27
2	Xhevat	Velisha	Berberi	3787	835/1	Arë	682,35	161,5	110.199,53		646		15.136,00		125.335,53
3	Benjamin	Qamili	Hysi	3787	834/1	Arë	665,40	161,5	107.462,10		646		14.586,00		122.048,10
4	Pellumb	Muhamet	Pasholli	3787	843/12	Arë	40,31	161,5	6.510,07		646		41.774,5	30.438,00	78.222,57
5	Irani	Sali	Pasholli	3787	377/101	Truall	129,03	290	37.418,70		1160			56.161,00	93.579,70
6	Sali	Sabri	Goce	3787	843/1	Arë	120,07	161,5	19.391,31		646		91.508,16		110.899,47
TOTALI							1.881,83		320.495,90	47,61		30.756,06	163.004,66	86.599,00	600.855,62

LISTA E PRONARËVE DHE PËRDORUESVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE ME MINIMUMIN E KOMPENSIMIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave	Vlera Totale Lekë
1	Belul	Xhevit	Topciu	3787	838/16	Arë	86,87	0,04	1.044,00	56.000,00
2	Muharem	Emin	Rusi	3787	838/23	Arë	90,74	1,38		56.000,00
3	Ledio		Biviku	3787					2.046,00	2.046,00
4	Zija	Hetem	Hysolli	3787	838/14	Arë	65,94	0,05	2.245,32	56.000,00
5	Zija	Hetem	Hysolli	3787	838/26	Arë	112,21	2,35	2.530,00	56.000,00
6	Albert	Ismail	Bashi	3787	838/1	Arë	22,06			56.000,00
7	Artur	Hythi	Subashi	3787	374/5	Arë	70,18		10.092,00	56.000,00
8	Dragua	Qemal	Bejleri	3787	374/4	Arë	113,05	4,76	17.461,64	56.000,00
9	Petrit	Dervish	Subashi	3787	836/35	Arë	20,83		462,00	56.000,00
10	Nexhmi	Hasan	Pasholli	3787	838/19	Arë	112,50	4,67		56.000,00
11	Ilirjan	Sello	Sharchi	3787	838/8	Arë	64,96			56.000,00
